



UNMIK/REG/2007/33  
12 dhjetor 2007

---

**REGULLORE NR. 2007/33**

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR  
SIGURINË NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR  
TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, të datës 3 dhjetor 2007 lidhur me Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 11 janar 2007,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë pushtetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në bazë të Rezolutës 1244 (1999) të KS të OKB-së as kompetencat dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-70), që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit, me kusht që:

A.

- (a) Fjalët “shtetet fqinje”, në nenet 3.1 7), të zëvendësohen me fjalët “territoret jashtë Kosovës”;

- (b) Fjala “qytetar/ët” në nenet 3.1 10) dhe në 281.1, të zëvendësohet me “banor/ët” ;
- (c) Neni 12.2 të ndryshohet si në vijim: “Para fillimit të punëve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni (përveç në raste emergjente) personi duhet ta ketë marrë lejen nga organet kompetente varësisht nga lloji i rrugës dhe ta ketë informuar policinë lidhur me këtë”
- (d) Neni 4.3 të ndryshohet si në vijim: “Në vendet ku janë të vendosura njësitet e KFOR-it apo të TMK-së, mbikëqyrja gjatë lëvizjes së këtyre njësiteve në komunikacionin publik po ashtu mund të bëhet nga punonjësit e autorizuar të atyre njësiteve.”
- (e) Fjala “kundërvajtje” në tërë tekstin e Ligjit të zëvendësohet me fjalët “shkelja e kësaj dispozite”;
- (f) Fjala “qytetar” në nenin 102.2 të shlyhet;
- (g) Neni 121 të ndryshohet si në vijim:

“121.1. Është rregull e përgjithshme që automjetet motorike t’i përdorin dritat e shkurtra

121.2. Përdorimi i dritave të gjata lejohet si përjashtim përveç nëse:

  - (a) Afrohet automjeti tjetër;
  - (b) Asnjë automjet tjetër nuk është përpara, i cili do të pengohej nga dritat e gjata;
  - (c) Automjeti drejtohet afër hekurudhës apo lundrës, ashtu që të ekziston mundësia e pengimit të trenit apo të lundrës;
  - (d) Shihet kolona e këmbësorëve.

121.3. Shkelja e kësaj dispozite do të dënohet me së paku 35 euro.”
- (h) Fjalët “shteti tjetër” në nenin 225.1 të zëvendësohen me fjalët “një shtet tjetër”
- (i) Neni 304.2 të shlyhet.
- (j) Në nenin 305.4, fjalët “dhe shenja KS nga neni 304” të shlyhen.
- (k) Fjala “Kosovë në nenin 376 të zëvendësohet me “Kosovo”

B.

Dispozitat e Vendimit ekzekutiv nr. 2003/13 për regjistrimin e automjeteve private në Kosovë nga banorët e përhershëm të Kosovës, të datës 30 gusht 2003 do të mbeten në fuqi.

Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin zyrtar përfundimtar të ligjit.

Nënshkruar sot, më 12 dhjetor 2007.

Joachim Rüecker  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm